

SKEDË INFORMUESE

Mundësi për aplikim të bashkive në 4 thirrjet për propozime për të promovuar barazinë gjinore (CERV-2026-GE) nën programin CERV

Synimi i thirrjeve:

Synimi i thirrjeve është mbështetja, avancimi dhe zbatimi i politikave gjithëpërfshirëse për promovimin e gëzimit të plotë të të drejtave nga gratë, barazisë gjinore, përfshirë balancën mes jetës profesionale dhe asaj private, pagën e barabartë midis grave dhe burrave, fuqizimin e grave dhe integrimin e perspektivës gjinore në të gjitha politikat dhe veprimet.

Fushat e veprimit të 4 thirrjeve:

Autoritetet kombëtare, vendore dhe rajonale, partnerët socialë (përfaqësues të punëmarrësve dhe të biznesit), inspektoratet e punës, organet e barazisë dhe organizatat e shoqërisë civile, në veçanti organizatat për të drejtat e grave, si dhe aktorë të tjerë të interesuar, ftohen të paraqesin projekte në kuadër të katër prioritetëve të mëposhtme:

Thirrja 1 - CERV-2026-GE WORK-LIFE Mbështetja e balancës mes jetës profesionale dhe asaj private, ndarja e barabartë e përgjegjësi të kujdesit, politikat miqësore për familjen në nivel punëdhënësish, si dhe vlerësimi i vendeve të punës në sektorin e kujdesit (

Thirrja 2 - CERV-2026-GE PAY-TRANSP-DIR Promovimi dhe mbështetja e zbatimit të dispozitave të Direktivës për Transparencën e Pagave dhe respektimi i parimit të pagës së barabartë për punë të barabartë dhe punë me vlerë të barabartë.

Thirrja 3 - CERV-2026-GE EQUAL-PART-REP Mbështetja e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të barabartë të grave dhe burrave në vendimmarrjen ekonomike dhe politike.

Thirrja 4 - CERV-2026-GE GENDER-STEREO Luftimi i stereotipeve gjinore në media dhe reklamim.

Kush mund të aplikojë dhe çfarë konsorciumi pranohet:

Aplikuesit duhet të jenë bashki nga vendet e BE-së ose vendet e lidhura me programin CERV, ku Shqipëria bën pjesë. Projektet mund të jenë kombëtare ose ndërkombëtare.

Propozimet duhet të paraqiten nga një konsorcium me të paktën **dy aplikantë** (si subjekte përfituese; jo subjekte të lidhura dhe as partnerë të asociuar), të cilët plotësojnë kushtet e mëposhtme: Përfituesit duhet të jenë subjekte publike ose organizata private, të themeluara rregullisht në një nga vendet e pranueshme, ose një organizatë ndërkombëtare.

Subjektet që janë të orientuara drejt fitimit duhet të dorëzojnë aplikime në partneritet me subjektete publike ose organizatat private jofitimprurëse.

Kushte të tjera:

- Aplikanti kryesor (domethënë "Koordinatori / Lead") nuk mund të paraqesë më shumë se **një aplikim** në këtë thirrje për propozime, për të gjitha prioritetet/temat. Në rast të propozimeve të shumta të paraqitura nga i njëjti aplikant kryesor, **të gjitha propozimet do të refuzohen** dhe nuk do të vlerësohen më tej.

Aktivitete të pranueshme:

Ndërtimi i kapaciteteve dhe trajnimi për punëdhënësit në sektorin publik dhe privat, në veçanti për menaxherët e burimeve njerëzore, lidhur me zbatimin e formave të punës miqësore për familjen dhe lejeve familjare për gratë dhe burrat, si dhe promovimin e të drejtave të parashikuara në Direktivën për Balancën Punë–Jetë dhe përfitimeve të politikave miqësore për familjen në vendin e punës.

Zhvillimi dhe/ose ofrimi i aktiviteteve trajnuese dhe mbështetëse të synuara për burrat, në lidhje me:

- a) prindërimin, duke u fokusuar në aftësi, mbështetje dhe angazhim me fëmijët; ose
- b) kujdesin afatgjatë për personat në varësi, duke u fokusuar në aftësi, mbështetje dhe angazhim me përfituesit e kujdesit, si dhe promovimin e përfitimeve të ndarjes së barabartë të përgjegjësisë të kujdesit ndërmjet grave dhe burrave.

Zhvillimi dhe zbatimi i programeve udhëzuese dhe trajnuese, si dhe promovimi i praktikave të mira dhe aktiviteteve të ndërgjegjësimit nga dhe për partnerët socialë, me qëllim ndërtimin e kapaciteteve të tyre për zbatimin e parimit të pagës së barabartë për punë të barabartë ose punë me vlerë të barabartë. Këto përfshijnë zbatimin e sistemeve të vlerësimit dhe klasifikimit të vendeve të punës neutrale nga këndvështrimi gjinor, vlerësimin e sistemeve ekzistuese të vlerësimit të punës dhe skemave të klasifikimit të pagave, si dhe forcimin e kapaciteteve për negociimin e pagës së barabartë.

Zhvillimi dhe/ose organizimi i nismave të mentorimit, këshillimit, rrjetëzimit dhe trajnimeve të synuara për gratë kandidate politike dhe/ose përfaqësuese të zgjedhura, përfshirë zhvillimin dhe/ose zbatimin e programeve trajnuese dhe aktiviteteve të tjera për ndërtimin e kapaciteteve; dhe/ose zhvillimi dhe/ose organizimi i trajnimeve mbi barazinë gjinore në politikë dhe paragjykimet gjinore të pavetëdijshme për liderët politikë (gra dhe burra).

Përiudha e zbatimit të projekteve:

Projektet duhet të zhvillohen brenda periudhës nga 12 deri në 24 muaj (zgjatja e periudhës së zbatimit të projekteve janë të mundshme, nëse janë të justifikueshme).

Buxheti total i thirrjes:

Nr.	Temat Prioritare	Buxheti total
1	CERV-2026-GE WORK-LIFE Mbështetja e balancës mes jetës profesionale dhe asaj private, ndarja e barabartë e përgjegjësi të kujdesit, politikat miqësore për familjen në nivel punëdhënësish, si dhe vlerësimi i vendeve të punës në sektorin e kujdesit.	7 milion euro
2	CERV-2026-GE PAY-TRANSP-DIR Promovimi dhe mbështetja e zbatimit të dispozitave të Direktivës për Transparencën e Pagave dhe respektimi i parimit të pagës së barabartë për punë të barabartë dhe punë me vlerë të barabartë.	5 milion euro
3	CERV-2026-GE EQUAL-PART-REP Mbështetja e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të barabartë të grave dhe burrave në vendimmarrjen ekonomike dhe politike.	6 milion euro
4	CERV-2026-GE GENDER-STEREO Luftimi i stereotipeve gjinore në media dhe reklamim	5 milion euro

Cili është buxheti i thirrjes për projekt:

Buxheti minimal për një projekt është **100,000 EUR** dhe maksimal është **500,000 EUR**. Thirrja ka një buxhet të përgjithshëm prej 23 milionë EUR, të cilat do të shpërndahen bazuar në projektet e miratuara.

Si bëhet aplikimi:

Pjesa A - Përfshin informacionin administrativ mbi subjektet aplikuese (koordinatori, përfituesit, subjektet e lidhura dhe partnerët e asociuar), si dhe buxhetin e përmbledhur të projektit. Plotësohet drejtpërdrejt online.

Pjesa B – Përshkrimi i veprimit që është pjesa teknike e propozimit.

Pjesa C - përmban të dhëna shtesë mbi projektin dhe kontributin e tij në treguesit kryesorë të performancës (KPI) të programit të BE-së. Plotësohet drejtpërdrejt online.

Kur është afati i fundit:

Afati i fundit për aplikim është më 28 Prill 2026, ora 17:00 (ora e Brukselit).

Linku i Thirrjeve:

<https://ec.europa.eu/info/funding-tenders/opportunities/portal/screen/opportunities/topic-details/CERV-2026-GE-WORK-LIFE>

<https://ec.europa.eu/info/funding-tenders/opportunities/portal/screen/opportunities/topic-details/CERV-2026-GE-PAY-TRANSP-DIR>

<https://ec.europa.eu/info/funding-tenders/opportunities/portal/screen/opportunities/topic-details/CERV-2026-GE-EQUAL-PART-REP>

<https://ec.europa.eu/info/funding-tenders/opportunities/portal/screen/opportunities/topic-details/CERV-2026-GE-GENDER-STEREO>